



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 5,7 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neneve 4,5 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe neneve 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur 03. 03. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, miratojë këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME-LOKALEVE AFARISTE TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE LIPJAN

1. Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim afatshkurtër prej 10 vitesh personave fizik dhe juridik paluajtshmëritë-lokalet afariste të cilat gjenden në zonën kadastrale në Lipjan si në vijim:

1.1. Lokali afarist me sipërfaqe prej 42m² gjendet në ngastrën kadastrale P-71409044-01920-0 në pronësi të komunës rr."Lidhja e Prizrenit" në Lipjan

1.2. Lokali afarist me sipërfaqe prej 50m² gjendet në ngastrën kadastrale P-71409044-01920-0 në pronësi të komunës rr."Lidhja e Prizrenit" në Lipjan.

2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi pronat-lokalet afariste ipen në shfrytëzim në afat prej 10 vitesh dhe çmimi fillestar do të jetë prej 4€ (kater euro) për m² nëpërmjet ankandit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

3. Procedurën e ankandit publik e udhëheq Komisoni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.404-13205 të dt.31.03.2014, në bazë të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

4. Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës afatshkurtër të regjistrojë në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim në periudhë afatshkurtër.

5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Spektori pronësor-juridik, Drejtorati për Gjeodezi e Kadastër dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

15Nr. 464-11851

Lipjan, më 04. 03. 2016

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJAN

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

